



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes inaguruese të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	09.12.2025

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj
Z. Flamur Bytyçi
Znj. Doruntina Zenelaj
Z. Urim Suka
Z. Astrit Salihu
Z. Nexhat Ramadani
Znj. Vlorë Kryeziu
Z. Bexhet Kuçi
Z. Visar Kuçi
Z. Mensur Selimaj
Z. Edon Sadikaj
Z. Aziz Bytyçi
Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani
Znj. Albulena Kokollari
Znj. Besa Kuçi
Z. Dardan Berisha
Z. Armend Krasniqi
Z. Labinot Halitjaha
Znj. Afërdita Mamaj
Znj. Merita Basha
Znj. Antigona Zyba
Z. Liridon Fandaj
Z. Qëndrim Elshani
Znj. Laureta Tafaj
Znj. Jehona Rrafshi
Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;

3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës;

Bexhet Kuçi - Përshëndes të pranishmit dhe uroj Kryetarin e komunës z.Bali Muharremaj për mandatin e tretë të fituar dhe gjithëashtu i uroj të gjithë anëtarët e kuvendit për mandatin e besuar nga qytetarët të cilët do ti përfaqësojnë qytetarët e Suharekës.

Pika 1. Dhënia e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

Bexhet Kuçi - Ftoj anëtarët e Kuvendit që të ngriten në këmbë dhe ta japim betimin.Bexhet Kuçi lexon betimin dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit përsërisin fjalët pas tij duke u betuar para kuvendit.

Pika 2.Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;

Bexhet Kuçi - fton Kryetarin që ta jap betimin.

Kryetari - betohet para Kuvendit dhe qytetarëve.

Pika 3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Suharekës;

Bexhet Kuçi - Ia jep fjalën zyrtarit ligjor që të jap sqarime lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit dhe komisionit i cili do ta mbikqyr procesin e zgjedhjes së Kryesuesit.

Avni Bytyqi - Si zyrtar ligjor jep sqarime lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit dhe thotë që duhet të formohet komisioni prej 3 ose 5 anëtarëve nga anëtarët e Kuvendit.

Bexhet Kuçi - Kërkon nga subjektet politike që të japin propozimet për Kryesues të Kuvendit.

Aziz Bytyqi - Përshëndes të pranishmit dhe i uroj të gjithë kandidatëve për marrjen e mandatit.Në emër të grupit të AAK-së propozojmë Bexhet Kuçi.

Urim Suka - Përshëndes të pranishmit dhe uroj të gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët janë zgjedhur për këtë mandat.Ne si grup i LDK-së propozojmë Nexhat Ramadani për Kryesues të Kuvendit.

Dardan Berisha - Përshëndes të pranishmit dhe i uroj gjithë anëtarëve të Kuvendit detyrën e re.Ne si grup i PDK-së nuk kemi propozim për Kryesues të Kuvendit.

Laureta Tafaj - Përshëndes të pranishmit.Ne LVV nuk kemi propozim për Kryesues të Kuvendit.Na priftë e mbara.

Jehona Rrafshi Lumi - Përshëndes të pranishmit dhe i uroj sukses anëtarëve të Kuvendit.Nisma Social Demokrate nuk ka propozim për Kryesues të Kuvendit.

Bexhet Kuçi - në bazë të rregullores ne duhet ta formojmë komisionin për mbikqyrjen e procesit të zgjedhjes së Kryesuesit.Kërkoj nga ju të vendosni se a po shkojmë me 3 anëtar apo me 5 anëtar.

Laureta Tafaj - mendoj që duhet me shku me 5 anëtar sepse duhet të përfshihen të gjitha subjektet politike.

Bexhet Kuçi - kërkon propozimet për anëtar të komisionit.

Aziz Bytyqi - në emër të AAK-së propozoj Visar Kuçi për anëtar të komisionot.

Urim Suka - në emër të LDK-së propozojmë për këtë komision Astrit Salihu.

Dardan Berisha - në emër të PDK-së propozojmë Labinot Halitjaha për anëtar të komisionit.

Qëndrim Elshani - LVV propozon Liridon Fandaj.

Jehona Rrafshi Lumi - në emër të NISMA-as do të merr pjesë në këtë komision Jehona Rrafshi Lumi.

Bexhet Kuçi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Visar Kuçi,Astrit Salihu,Labinot Halitjaha,Liridon Fandaj dhe Jehona Rrafshi Lumi.

Unanimisht Miratohet

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor i njofton të pranishmit që Kuvendi i ka 27 anëtar dhe në listë të nënshkrimeve janë 26 anëtar të cilët kanë dhënë deklaratën e betimit. Fton anëtarët e Kuvendit një nga një që të votojnë.

Komisioni fillon me numërimin e votave dhe konstaton që në kuti janë 26 fletvotime. Komisioni konstaton që Bexhet Kuçi ka 16 vota, Nexhat Ramadani 7 vota dhe të pa vlefshme janë 3 vota.

Laureta Tafaj - në emër të grupit të LVV-së urojmë zgjedhjen e Kryesuesit. Na priftë e mbara dhe urojmë për bashkëpunim.

Kryetari - Përsëendet të pranishmit dhe mban fjalimin e rastit si Kryetar i Komunës.

Bexhet Kuçi - Përsëendet të pranishmit, i falemnderon të pranishmit për mbështetjen dhe njëherit mban fjalim rasti për rizgjedhjen si Kryesues i Kuvendit komunal.

Takimi përfundoi: 11: 00

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj